

Afet Mamuti, PhD<sup>1</sup>

UDC:  
343.54:340.13

## **ROLI I SHËTETIT NË PARANDALIMIN E DHUNËS NË FAMILJE**

### **УЛОГАТА НА ДРЖАВАТА ВО ПРЕВЕНЦИЈАТА НА СЕМЕЈНОТО НАСИЛСТВО**

### **THE ROLE OF THE STATE IN PREVENTING DOMESTIC VIOLENCE**

#### **Abstract**

Protection from Domestic Violence as a legal standard characterizes the institutional actions that state and society should take to prevent the violations of rights and the prevention of domestic violence and the rehabilitation of victims of domestic violence.

The topic of domestic violence, seen in the context of the culture and tradition of our society, was not sufficiently addressed. Even though domestic violence has a disadvantage to the physical and psychological health of humans, the concept of domestic violence differs from the concept of all other forms of violence occurring in society.

Domestic violence poses a complex problem that hinders the attainment of equality, harmony, and any normal development of the family of relationships in general.

Through the practice of domestic violence, perpetrators violate the most basic human rights protected by all social norms. In many cases, domestic violence is considered a private matter that belongs to the family alone, but not to society in general, especially due to the tradition and culture of our society which dislikes speaking out publicly on such matters.

---

<sup>1</sup> Associate Professor (Profesor inordinar), Faculty of Law, University of Tetova, afet.mamuti@unite.edu.mk

The presence of domestic violence does not necessarily depend on the degree of development of a society, as this phenomenon is present in all societies and differs only from the form of appearance and its intensity. Raising the level of education, emancipation and awareness of a society and combining together with institutional coordinated action is an important factor in avoiding the causes of violence.

**Key words: violence, domestic violence, the concept of violence, prevention of violence, the family.**

## **ROLI I SHTETIT NË PARANDALIMIN DHUNËS NË FAMILJE**

### **Dhuna në familje**

Me dhunë në familje nënkuptojmë maltretimin, lëndimin, rrezikimin e sigurisë, lëndimin trupor, dhunën seksuale apo psikike, dhunën fizike apo ekonomike me të cilën shkaktohet ndjenjë e pasigurisë, rrezikut apo frikës, përfshirë edhe kërcënimet për veprime të tilla, kundrejt bashkëshortit, prindërve dhe fëmijëve apo personave tjerë që jetojnë në bashkësi martesore apo jashtëmartesore apo shtëpi të përbashkët, si dhe kundër bashkëshortit të tanishëm dhe të mëparshëm, partnerit jashtëmartesor apo personit me të cilin kanë fëmijë të përbashkët apo që janë në marrëdhënie personale, pa marrë parasysh se kryerësi e ndanë apo e ka ndajtur vendbanimin e njëjtë me viktimën.<sup>2</sup>

Dhuna në familje është çdo akt dhune, qoftë veprim apo mosveprim i ushtruar midis personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik.<sup>3</sup> Pavarësisht se në çfarë forme shfaqet ajo, që e njëjta të konsiderohet dhunë në familje duhet që kryerësi i dhunës dhe viktima të jenë në raport gjinie, qoftë ajo e gjakut, civile apo e kru-shqisë apo edhe në ndonjë relacion tjetër personal para apo në momentin e shfaqjes së dhunës. Të gjitha format e dhunës në familje kanë një qëllim, që të vendosin dhe mbajnë në kontroll të plotë viktimën. Të gjitha këto, kryerësi i dhunës synon që t'i arrij përmes ushtrimit të pushtetit duke dominuar, poshtëruar, izoluar, kërcënuar, frikësuar, mohuar dhe fajësuar viktimën.

---

<sup>2</sup> Neni 3 i "Ligjit për parandalimin, pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje", Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 138 e datës 17.09.2014

<sup>3</sup> "E drejta familjare", Prof. As. Dr. Arta M.Balili, Tiranë 2006, fq.257

Dhuna në familje mund të jetë:

- Dhuna fizike direkte duke filluar nga kontaktet e padëshiruara fizike me dhunimin dhe vrasjen. Dhuna fizike indirekte mund të përfshijë shkatërrimin e objekteve, goditjen ose hedhjen e objekteve afër viktimës ose lëndimin e kafshëve shtëpiake.

- Abuzimi mendor ose emocional, duke përfshirë kërcënimet verbale për dhunë fizike ndaj viktimës, vetvetes ose të tjerëve duke përfshirë fëmijët dhe dhunën verbale që përfshinë kërcënimet, ofendimet, nënçmimet dhe sulmet.

- Kërcënimet joverbale mund të përfshijnë gjeste, shprehje të fytyrës dhe pozicionet e trupit.

- Abuzimi psikologjik mund të përfshijë gjithashtu kontrollin ekonomik dhe/ose social si kontrollimin parave të viktimës dhe burimeve të tjera ekonomike, duke ndaluar viktimën të shohë miqtë dhe të afërmit, duke sabotuar në mënyrë aktive marrëdhëniet shoqërore të viktimës dhe duke e izoluar viktimën nga kontaktet sociale.<sup>4</sup>

Ajo që e bën të veçantë dhunën në familje janë rrethanat specifike në të cilat ajo paraqitet. Për dallim nga format e tjera të dhunës ku shoqëria ka qenë më aktive dhe reaguese ndaj dhunës në familje duket se ka qenë më neglizhente për një kohë të gjatë, për shkak të botëkuptimit që ekzistonte për te. Edhe pse flasim për dhunën në familje ku si viktimë dhe si kryerës mund të paraqitet çdo anëtar i saj, megjithatë rastet më të shpeshta nga të dhënat në praktikë janë me bazë gjinore. Sipas statistikave, 93% e autorëve të raportuar dhe të dënuar të krimeve gjatë dhunës në familje në periudhën e hetuar janë burra dhe 82% e viktimizeve janë gra.<sup>5</sup>

Dukuria e dhunës në familje është prezente në çdo shoqëri dhe sjell pasoja negative në shëndetin e viktimës në aspektin psiko-fizik dhe social. Viktimat shpeshherë nuk janë në gjendje të marrin vendime të pavarura, të çojnë zërin për padrejtësitë ndaj tyre dhe nuk janë në gjendje të mbrojnë vetveten dhe fëmijët për shkak të frikës nga pasojat e mëvonshme. Edhe në rastin e reagimit dhe masave që duhet ndër-marrin institucionet e shtetit, nuk ekzistojnë praktika unike të trajtimit

<sup>4</sup> Pallavi Mahajan, Critical Eye Analysis Of Dometic Violence Act, 2005 (Protection Of Women Against Domestic Violence Act), SSRN, May 13, 2011, p.2

<sup>5</sup> “Zëri i drejtësisë”. Vlerësimi i procedurave gjyqësore për rastet e dhunës në familje, me fokus të veçantë në menaxhimin e lëndëve nga perspektiva gjinore, Prof. Stojanka Mirçeva, Prof. Nikolina Kelig, Prof. Violeta Çaçeva, “Institut për hulumtime sociologjike dhe juridiko-politike” i Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi”-Shkup, 2014

të viktimave në mes vendeve të ndryshme apo edhe brenda vendit me rastin e trajtimit të viktimave nga dhuna në familje. Shfaqja e dhunës jo gjithmonë varet vetëm nga rregullativa ligjore dhe kushtet që kanë institucionet për luftimin e saj, por ka ndikim edhe aplikimi i normave zakonore, morale dhe religjioze në atë shoqëri dhe karakteri personal i palëve në atë marrëdhënie. Kjo pasi shpeshherë vet denoncimi i dhunës është bërë shkak për acarimin e marrëdhënies dhe shfaqjen e dhunës së re edhe më me intensitet. Kjo e bën që rastet e dhunës në familje asnjëherë të ndriçohen qind për qind, apo që vetëm një numër i vogël i rasteve të ndriçohet, veçanërisht kur si viktimat paraqiten gratë dhe fëmijët. Prandaj edhe në raportimin e rasteve të dhunës në familje ka dallim në mes të dhënave zyrtare që paraqiten dhe “numrit të errët” që realisht është në praktik.

Për herë të parë si dhuna në familje në legjislacionin e RM-së është paraparë nga viti 2004, kurse në vitin 2008 është sjellur për herë të parë Strategjia nacionale për mbrojtje nga dhuna në familje 2008-2011 dhe e cila është zbatuar me ndihmën e 5 Agjencioneve të KB (UNDP, UNICEF, UNWOMEN, UNFPA dhe WHO) dhe Mbretëria e Holandës. Më pas është hartuar Strategjia Nacionale për pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje 2012-2015, dhe e fundit është 2018-2021. Duke krijuar politika dhe programe për promovim sistematik të principit të mundësive të barabarta, me qëllim të ndryshimit të zakoneve shoqërore për eliminimin e të gjitha paragjykimëve dhe çdo praktike të mbështetur në inferioritetin apo superioritetin e njëres gjini mbi tjetrin, si rezultat i pikëpamjeve tradicionale, sistemi për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave është përmirësuar duke hapur qendra për këshillim të viktimave të dhunës në familje.

### **Dhuna ndaj grave**

Si rezultat i botëkuptimit tradicional patriarkal shoqëritë në ballkan kanë qënë historikisht të dominuara nga meshkujt. Grave u është imponuar që të kenë rolin e të nënshtruarve, pasi konsideroheshin si qenie njerëzore me më pak vlerë dhe që duhet ti shërbej burrit. Dhuna ndaj grave është e rënjosur në pabarazitë dhe diskriminimin ndaj grave dhe parandalimi dhe zhdukja e saj duhet të bazohet në barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave. Bashkëshorti ndaj të cilit ushtrohet dhunë ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës me kërkesë për vendosjen si masë urgjente

largimin e bashkëshortit që ushtron dhunë nga banesa bashkëshortore.<sup>6</sup> Heshnja e dhunës, frika nga pasojat, mbetja e saj vetëm brenda 4 mureve të shtëpisë, paraqet një dukuri të shpeshtë në shoqërinë tonë.

“Dhuna ndaj grave” ose “Dhuna me bazë gjinore” paraqet atë akt të shëmtuar të ushtruar ekskluzivisht kundër grave apo vajzave. Dhuna ndaj grave është një problem publik i rëndësishëm shëndetësor, si dhe një shkelje themelore e të drejtave njerëzore të grave.<sup>7</sup>

Dhuna ndaj grave paraqet problem serioz për çdo shoqëri në përgjithësi dhe në shoqërinë tonë në veçanti. Kjo bazohet edhe në faktin se sipas statistikave në shtetin tonë çdo e dyta grua është viktimë e dhunës psikike dhe çdo e pesta grua në njëfarë forme është viktimë e dhunës fizike, ndërsa kur bëhet fjalë për dhunën seksuale ndërmjet partnerëve kjo është një temë që akoma rrallë diskutohet edhe për shkak të botë-kuptimeve që ekzistojnë për këtë temë.

Kjo gjendje bëhet edhe më alarmante kur gruaja është viktimë nga vet anëtar i familjes, qoftë ai bashkëshorti, bashkëshorti jashtëmarte-sor, prindi apo fëmija, kjo pasi në vend se shtëpia apo këto anëtar të jenë ata që japin ndjenjën e sigurisë për gruan apo anëtarin tjetër të familjes ndodh pikërisht e kundërta që këta të shkaktojnë pasigurinë për gruan.

- Bazuar në statistikat e Organizatës Botërore të Shëndetësisë vlerësohet se 1 në 3 (35%) të grave në mbarë botën në jetën e tyre kanë përjetuar të paktën njëherë dhunë fizike apo seksuale. Kjo shifër në disa vende arrin në 70% të grave që kanë përjetuar dhunë fizike një herë në jetën e tyre. (WB)

- Afërsisht 7% e grave kanë qenë të dhunuara nga ndonjë person jopartner. (WB)

- Në total rreth 125 milion është i grave që kanë përjetuar gjymtim të organeve seksuale. (WB)<sup>8</sup>

Dhuna ndaj grave mund të shfaqet si dhunë fizike, si dhunë psikike dhe si dhunë seksuale.

**Dhunë fizike** konsiderohet çdo manifestim i forcës fizike mbi trupin e gruas, qoftë ajo si goditje, grushtim, shuplaka, tërheqje për

<sup>6</sup> Neni 62 i Kodit të Familjes të Republikës së Shqipërisë

<sup>7</sup> Violence Against Women: Global Picture Health Response, WORLD HEALTH ORG., [http://www.who.int/reproductivehealth/publications/violence/VAW\\_infographic.pdf](http://www.who.int/reproductivehealth/publications/violence/VAW_infographic.pdf) (last visited Apr. 24, 2014).

<sup>8</sup> <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/violence-against-women>

flokësh, gjuajtje me sende të forta, shkaktim i lëndimeve dhe plagëve me çfarëdo lloj armësh të zjarrit apo të ftohta etj.

**Dhuna psikike** mund të shkaktohet përmes formave të ndryshme të kontrollit ndaj gruas, kontrollimin të kontakteve, izolimit, xhelozisë, shkaktim të vuajtjeve emocionale, pengimin për të punuar jashta shtëpisë apo në profesion, nënçmimin dhe poshtërimin para të tjerëve, kërkimin e leje edhe për shkuarje te mjeku, kërkim llogarie për çdo detaj dhe moment se ku gjendet etj.

**Dhunë seksuale** konsiderohet kryerja e marrëdhënies seksuale me dhunë dhe çdo forme tjetër forme tjetër që manifestohet ajo në kundërshtim me vullnetin e gruas.

Sipas statistikave të Ministrisë për punë dhe politik sociale dhuna psikologjike është më e përhapur sesa dhuna fizike dhe seksuale (2009-2012).

### **Dhuna ndaj fëmijëve**

Fëmijët ndodh që të jenë viktima të dhunës në familje edhe për shkak të rolit historik të tyre ku gjithmonë kanë qenë nën pushtetin e babait apo ndonjë anëtar tjetër mashkull të familjes. Këtë pozitë diskriminuese e hasim që nga e drejta romake, e drejta zakonore shqiptare dhe normat e religjioneve të cilat burrit si i pari i shtëpisë i japin pozitë dominuese e cila shpesh keqpërdorej për shkak të forcës që kishin dhe arbitraritetit në marrje të vendimeve dhe i bënte fëmijët viktima. Fëmijët si anëtarë të familjes edhe sot e kësaj dite ndodh të jenë viktima të dhunës në familje. Fakti i moshës së vogël apo i mospasjes së forcës fizike apo pamundësisë që të kujdesen vet për vetveten i bën ata që jenë në rolin e viktimës.

Nga të dhënat e sublimuara të cilat janë bërë në bazë të paraqitjeve në SOS-telefonatat për fëmijë dhe të rinj, tregojnë se të drejtat e fëmijëve më së shumti shkelen gjatë procedurave për shkurorëzim të martesës, gjatë dhunës në familje dhe detyrimit për lypje, respektivisht keqpërdorimit të punës së fëmijëve, si dhe në rastet e keqpërdorimit seksual nga ana e të afërmit ose ndonjë të njohuri të fëmijës.<sup>9</sup>

Nga praktika shpeshherë ndodh që kryerës të jetë burri dhe sulmi të jetë drejtuar ndaj gruas dhe ndaj fëmijës njëkohësisht. Në këto raste dilema e gruas është e madhe dhe vëhet në pozitë më të vështirë sepse

<sup>9</sup> <https://akademik.mk/megashi-detsata-se-zhrtvi-na-brakorazvodnite-postapki-na-semejnoto-nasilstvo-a-se-zloupotrebuva-i-nivniot-trud/>

nuk din se a duhet të mbroj vetveten paraprakisht apo fëmijën. Në rastet e dhunës në familje, në të cilën njëri prind është viktimë e dhunës dhe tjetri është kryerësi, fëmijët mund të jenë edhe më pak të në gjendje t'u drejtohen prindërve për mbështetje dhe siguri.<sup>10</sup> Për shkak të rolit të shtetit dhe shoqërisë ku në qendër të vëmendjes kanë “parimin e mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës”, edhe gjatë krijimit të normave ligjore dhe zhvillimit të procedurave gjyqësore dhe administrative, gjithmonë merret për bazë ky parim. Kjo mund të vërehet ndër të tjera edhe nga “Rregullorja për kujdes mjekësor ndaj fëmijëve viktimë të dhunës në familje” e nxjerr nga Ministri i shëndetësisë, në të cilën është paraparë në detaje mënyra e sjelljes së personelit mjekësor në rastet kur për pacient kanë fëmijët që kanë statusin e viktimave nga dhuna në familje. Kjo rregullore ka paraparë në detaje situatën e fëmijës kur parqitet në rolin e dëshmitarit edhe kur dhuna nuk është e drejtuar kundër tij, pasi edhe kjo situatë konsiderohet e dëmshme për shëndetin e fëmijës dhe pasjell pasoja negative. Fëmijët viktimë të dhunës në familje kanë pasoja me efekte afatshkurtra dhe afatëgjate. Efektet afatgjate të dhunës manifestohen me: shqetësime, rëndim të sjelljes apo sjellje agresive, regres në zhvillim, vështirësi në të mësuar, depresion dhe anksozitet, tërheqje nga kontaktet sociale.<sup>11</sup> Gjithçka që vlen si procedurë dhe kushte për viktimën kur është grua, vlen edhe për rastet e fëmijëve, madje dhe me përkujdesje edhe më të shtuar.

Në rastet kur dhunën ka shkaktuar fëmija i mitur atëherë institucionet nuk do të zbatojnë dispozitat e Ligjit për parandalimin, pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, por dispozitat e ligjeve tjera, sikurse Ligjit për të drejtat e fëmijëve, Ligjit për familje, Kodit penal etj.

### **Roli i shtetit në krijimin e kuadrit ligjor për luftimin e dhunës në familje**

Dhuna si dukuri nuk është e pashmangshme, dhe e njëjta mund të çrrënjoset dhe parandalohet me veprime të kordinuara të më shumë sektorëve shtetërorë dhe shoqëror. Shtetet duhet të rrisin përpjekjet e tyre për të përdorur të gjitha instrumentet e disponueshme globale dhe

<sup>10</sup> Lois A. Weithorn, *Domestic Violence and Children: Analysis and Recommendations*, University of California Hastings College of the Law, 1999, p.6

<sup>11</sup> “Rregullorja për kujdes mjekësor ndaj fëmijëve viktimë të dhunës në familje” e nxjerr nga Ministri i shëndetësisë, pjesa e shtojcës.

rajonale për të drejtat e njeriut me qëllim të vendosjes së sistemeve efektive për parandalimin dhe pengimin e dhunës në familje. Në këtë drejtim edhe Maqedonia bazuar në legjislacionin aktual ofron mbrojtje adekuate për viktimat nga dhuna në familje. Maqedonia ofron mbrojtje juridike penale dhe juridike civile për viktimat e dhunës familjare në përputhje me rekomandimet dhe standardet ndërkombëtare. Shteti përmes institucioneve të tija (legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor) po ndërmerret një sërë masash për parandalimin e dhunës në familje:

Garancinë për mbrojtjen juridike të viktimave të dhunës, Maqedonia e siguron përmes kornizës juridike, edhe atë: Kushtetutës; Dokumenteve ndërkombëtare të ratifikuara; Ligjeve dhe Akteve nënligjore.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut garanton parimin e barazisë dhe ndalimin e diskriminimit nga më shumë baza, përfshirë edhe gjininë. Kështu, në nenin 9 Kushtetuta thotë se të gjithë qytetarët janë të barabartë në liritë dhe të drejtat pavarësisht gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, prejardhjes nacionale dhe sociale, besimit politik dhe fetar, pozitës pasurore dhe shoqërore.<sup>12</sup>

Ligjet që sanksionojnë dhe që pengojnë dukurinë e dhunës në familje janë: Kodi Penal; Ligji për parandalimin, pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje; Ligji për familje; Ligji për mundësi të barabarta ndërmjet grave dhe burrave; Ligji për mbrojtje shëndetësore; Ligji për ndihmë juridike falas etj.

Dhuna në familje për herë të parë është inkriminuar si veprë penale në Kodin penal në vitin 2004, ku është dhënë dhe kuptimi i saj. Dhunën në familje Kodi penal nuk e ka paraparë si veprë të posaçme penale, por e ka sanksionuar nëpër veprat e tjera penale. Kështu, sa herë kur kryhet ndonjëra nga veprat penale në rrethana të dhunës në familje, sanksionet janë shumë më të ashpra se sa kur ajo kryhet në rrethana të tjera, pasi sistemi penal ndjek një politik më të ashpër për luftimin e kësaj dukurie. Fakti që vepra penale është kryer gjatë dhunës në familje, ndjekja bëhet sipas detyrës zyrtare dhe dënimi është më i ashpër se sa forma themelore, kjo udhëzon në mbrojtje të veçantë të anëtarit të familjes nga ana e shtetit.<sup>13</sup> Sanksionet penale zakonisht për veprat penale të kryera si rezultat i dhunës në familje variojnë nga 3 muaj deri 10 vjet apo dënim i përjetshëm. Një risi tjetër që është paraparë në ndryshimet e Kodit penal më 2009, është që kryerësi i dhunës në familje të “ndjek

<sup>12</sup> Neni 9 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut

<sup>13</sup> Strategjia nacionale për pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje 2012-2015, Ministria për punë dhe politik sociale, f.14



programin për punë me të dënuar për vepra penale të kryera gjatë ushtrimit të dhunës në familje.”<sup>14</sup> Edhe Ligji për procedurë penale ka paraparë masa të veçanta kur palë në procedurë janë kryersi dhe viktima e dhunës në familje, me ç’rast viktimës në të gjitha fazat e procedurës i sigurohet mbrojtje e veçantë me qëllim që mos të lejohet viktimizim i dyfishtë it ë njëjtës. Procedura për këto raste është urgjente.

Ligji themelor që siguron mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje në procedurë civile është Ligji për parandalimin, pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje i miratuar më 2014, përmes të cilit rregullohen veprimet e koordinuara të institucioneve dhe shoqatave civile në parandalimin e dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave.

Dhuna në familje, dhuna ndaj grave, si një formë e diskriminimit dhe shkelje e të drejtave të njeriut është e sanksionuar përveç me normat juridike nacionale poashtu edhe nga instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, siç janë: Deklarata Universale e KB për të Drejtat e Njeriut; Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (1950); Pakti Ndërkombëtar për të Drejta Civile dhe Politike; Deklarata për eliminimin e diskriminimit ndaj grave; Konventa e KB për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të gruas (1979); Deklarata e Pekingut dhe Platforma për Aksion (1995) e miratuar në Konferencën e IV Botërore për Gratë në Peking; Konventa e Stambollit e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (2011) etj.

### **Roli i organeve shtetërore në parandalimin e dhunës në familje**

Parandalimi dhe pengimi i dhunës në familje kërkon një koordinim të më shumë organeve shtetërore dhe organizatave joqeveritare të cilat janë të parapara edhe në dispozita ligjore. Ligji për parandalimin, pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje ka paraparë organet të cilat kanë kompetencë që të merren me luftimin e dukurisë së dhunës në familje dhe me trajtimin e rasteve të dhunës, siç janë: Ministria për punë dhe politikë sociale, Ministria e punëve të brendshme, Ministria e shëndetësisë, Ministria për arsim dhe shkencë, Ministria e drejtësisë, njësitë e vetëqeverisjes lokale, institucionet të cilat kryejnë detyra nga fusha e mbrojtjes sociale, mbrojtjes së fëmijëve, punëve të brendshme, shëndetësisë, punësimit dhe arsimit, që ndërmarrin masa për mbrojtjen

<sup>14</sup> Neni 56 i Kodit Penal, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 114/2009

e e viktimave dhe mbrojtje të dhunës, realizojnë bashkëpunim dhe koordinim ndërmjet tyre.<sup>15</sup> E veçanta e këtij ligji është edhe krijimi i “Trupit koordinativ nacional kundër dhunës në familje” me përfaqësuar nga të gjitha institucionet e cekura më lartë si dhe sjellja e “Strategjisë nacionale për parandalimin, pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje” të cilën e sjell Qeveria për afat pesë vjeçar.

Bazuar në të dhënat e Ministrisë për punë dhe politik sociale, në Maqedoni funksionojnë vetëm katër qendra rajonale për viktimat e dhunës në familje, nga të cilat vetëm ajo e Shkupit është funksionale. Po ashtu edhe organizatat civile kanë krijuar qendra emergjente për vendosjen e viktimave të dhunës në familje, ku viktimat mund të rri nga 24 deri 48 orë në të.

Parandalimi i dhunës në familje është paraparë të bëhet përmes provimit të programeve nëpër shkolla dhe institucione tjera të cilat në fokus do të kenë të kuptuarit e dukurisë së dhunës si një e keqe për individin dhe shoqërinë, të kuptuarit e barazisë gjinore, të kuptuarit për pasojat nga dhuna në familje, zgjidhjen paqësore të konflikteve etj. Po ashtu rol të rëndësishëm në këtë drejtim kërkohet që të marrin edhe mjetet e informimit, sikurse ato të shkruarar edhe ato elektroniket për informim të drejtë për dukurinë e dhunës në familje dhe arritjen e efekteve për ngritje të vetëdijes.

**Qendra për punë sociale** - Si organ më i thirrur që të merren drejtpërdrejtë me këtë çështje janë Qendrat për punë sociale të cilat duhet të veprojnë në këto raste sa herë kur kanë ndonjë informacion për prezencë të dukurisë së dhunës në familje. “Çdo qytetar është i detyruar të denoncojë çdo informatë të dhunës në familje në një stacion policor, qendër për punë sociale, shoqatë ose linjën kombëtare SOS. Institucionet kompetente të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni duhet të veprojnë edhe me kërkesë anonime.”<sup>16</sup> Detyrimi për denoncim të informative për dhunë në familje përfshin edhe të gjithë personat e tjerë zyrtarë që merren me çështje të mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve, policisë, shëndetësisë, arsimit etj.

Masat të cilat mund t’i ndërmerr Qendra për punë sociale janë: vendosja e viktimës në vend të sigurt, ofrimi i mbrojtjes shëndetësore nëse ka nevojë, vazhdimi i shkollimit të fëmijëve nëse janë në shkollë,

<sup>15</sup> Neni 5 i Ligjit për parandalimin, pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, Gazeta zyrtare e RM-së, nr.138/14, datë: 01.01.2015

<sup>16</sup> Ligji për parandalimin, pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, Gazeta e Republikës së Maqedonisë nr. 138/2014, 33/2015 dhe 150/2015

ndihmë ekonomike dhe vazhdim të marrëdhënies së punës, intervenim dhe trajtim psiko-social, këshilla juridike falas, këshilla eventuale dhe masa tjera të nevojshme që janë të domosdoshme për mbrojtjen e viktimës. Marrja e masave nga ana e Qendrës për punë sociale nuk janë të lidhura me veprimet apo iniciimin e procedurës nga gjykata. Edhe në rastet kur gjykata vendos për ndalesa, urdhëresa dhe detyrime ndaj kryerësit që të ndal dhunën në familje, zbatimin, realizimin dhe ndjekjen e tyre e kryen Qendra për punë sociale. Në rastet kur rreziku nga paraqitja e dhunës mund të rishfaqen sërish dhe më me intensitet pas denoncimit të dhunës atëherë për zbatimin e këtyre masave kompetente është policia. Policia duhet të mbikëqyr masat që shqiptohen për ndalim të: kërcënimit, komunikimit, afrimit tek banesa, lëshimit të banesës, marrjes dhe përdorimit të armës. Për të gjitha këto veprime policia ka detyrim që të njofton gjykatën dhe Qendrën për punë sociale.

**Gjykata** po ashtu ka rol kyç në parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj gruas. Kështu ajo në procedurë civile siguron mbrojtje përmes shqiptimit të masave të përkohshme për mbrojtje të viktimave, në bazë të propozimit të parashtruar. Gjykata është e detyruar që në mënyrë ex officio të mbaj llogari për respektimin e disa parimeve në procedurë, siç është parimi i urgjencës në procedurë, përjashtimin e publikut etj. Vendimi i gjykatës në këtë rast ka rol preventiv dhe pengon ushtrimin e dhunës ndaj viktimës dhe kryerjen e veprës penale.

Vendimi i gjykatës në këto raste mund të parashikoj:

- Ndalimin e dhunës së mëtejshme apo pengimin se do të shkaktoj të njëjtën;
- Ndalimin për ta shqetësuar, telefonuar apo kontaktuar në ndonjë formë direkte apo indirekte;
- Ndalimin për të iu ofruar në distancë në më pak se 100m nga vendbanimi, shkolla, vendi i punës apo vend i i caktuar të cilin e frekuenton shpesh viktimja;
- Largimin nga shtëpia të dhunuesit pavarësisht pronësisë;
- Ndalimin e posedimit të armës apo e njëjta ti merret;
- Mjekimin e detyrueshëm etj.

### **Roli i shoqatave civile në parandalimin e dhunës në familje**

Shoqatat civile kanë një rol të rëndësishëm në parandalimin e dhunës në familje dhe në trajtimin e viktimave nga dhuna në familje. Të gjitha veprimet që ndërmarrin të njëjtat i bëjnë në koordinim me

institucionet e tjera shtetërore të përcaktuar në bazë të protokollit për bashkëpunim të hartuar paraprakisht. Përveç katër strehimoreve për vendosjen e viktimave të dhunës në familje, në Maqedoni funksionojnë edhe dy qendra krize të administruara nga organizatat joqeveritare (njëra siguron vendosjen deri në 6 muaj, kurse tjetra është për vendosje urgjente deri në 48 orë). Zakonisht në këto qendra sistemohet viktimat e dhunës në familje, dhunës nga partneri intim dhe në raste të tjera vendosen edhe fëmijët e tyre nëse kanë fëmijë. Shoqatat civile sa herë që kanë informacion për prezencë të dhunës në familje kanë detyrim që të njoftojnë Qendrën për punë sociale për marrjen e masave të koordinuara për rastin në fjalë.

Bazuar në situatën që kalon Maqedonia, organizatat civile paraqiten partner shumë i rëndësishëm i Qeverisë dhe organeve tjera shtetërore për promovimin dhe avancimin e të gjitha formave dhe metodave për krijimin e strategjisë dhe për luftimin e dukurisë së dhunës në familje.

## SUMMARY

Domestic violence is any act of violence, whether an act or an omission exercised between persons who are or have been in a family relationship, resulting in violation of physical, moral, psychological, sexual, social, economic integrity. No matter what form appears that the same to be considered domestic violence the perpetrator of the violence and the victim should be in the ties of filiations, established by blood, by law in certain cases, or by a judgment of adoption, or in any other personal relation before or at the moment of the occurrence of violence. Domestic violence can be appearing as physical, psychological and sexual violence.

Macedonia provides criminal and civil legal remedies for victims of domestic violence in accordance with international recommendations and standards. The state through its institutions (legislative, executive and judicial) is undertaking a series of measures to prevent domestic violence.

The Laws sanctions and preventing the occurrence of domestic violence are: The Criminal Code; The Law on Prevention and Protection from Domestic Violence; The Family Law; The Law on Equal Opportunities between Women and Men; The Law on Health Care etc.

**Recenzentë:**

**Prof. Dr. Hamdi Podvorica**

**Prof. Dr. Arta Bilalli**

Literatura:

- “E drejta familjare”, Prof. As. Dr. Arta M.Balili, Tiranë 2006
- Lois A. Weithorn, “Domestic Violence and Children: Analysis and Recommendations”, University of California Hastings College of the Law, 1999
- Michael H. Tonry, “The Oxford Handbook of Crime and Public Policy”, Oxford University Press, 2009
- Gruevska - Drakulevski "Dhuna në Familje në Republikën e Maqedonisë", Shkup, 2013
- Pallavi Mahajan, “Critical Eye Analysis Of Domestic Violence Act”, 2005 (Protection Of Women Against Domestic Violence Act), SSRN, May 13, 2011
- Ligji për Parandalimin, Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 138/2014, 33/2015, 150/2015
- Kodi Penal i RM-së, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 114/2009
- “Rregullorja për kujdes mjekësor ndaj fëmijëve viktime të dhunës në familje” e nxjerr nga Ministri i shëndetësisë, pjesa e shtojcës.
- Raporti Botëror i Shëndetit, Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2005
- Strategjia nacionale për pengimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje 2012-2015, Ministria për punë dhe politik sociale